



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2369/1 prot.

Tiranë, më 13.11.2024

Lënda: Mendim mbi projektligjin *“Për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5258/2 prot., datë 06.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 2369 prot., datë 07.11.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin *“Për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”* (në vijim, *“projektligji”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga përmbajtja e tyre konstatojmë se hartimi i këtij projektligji vjen si domosdoshmëri e përafrimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar. Ndërkohë, vërejmë se në relacionin shoqërues nuk është përcaktuar shkalla e përfarimit, si dhe nuk janë bashkëlidhur Tabelat e Përputhshmërisë me legjislacionin përkatës evropian (rregulloret apo direktivat), instrumente të cilat i vlerësojmë të rëndësishme dhe ndihmëse, në përcaktimin e një analize të detajuar të këtij harmonizimi, si dhe nevojës së ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore.

Për sa më lart, meqenëse proceset përpunuese të të dhënave personale të pasagjerëve janë të një game të gjerë, respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale gjatë kryerjes së veprimtarisë së institucioneve të përfshira, përbën një detyrim thelbësor.

Në vijim, propozojmë të mbahen në konsideratë disa komente dhe sugjerime për Projektligjin, si më poshtë vijon.

Në pikën **10, të nenit 2, të projektligjit**, në mënyrë që të unifikohet terminologjia e përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale,

sugjerojmë që togfjalëshi “*përdorim*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*përpunim*” i të dhënave.

Në **nenin 2 të projektligjit**, sugjerojmë të shtohet një pikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë të gjitha format e përpunimit të të dhënave, me këtë përmbajtje: “*Përpunimi i të dhënave është çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave*”.

Në **pikën 19, të nenit 2, të projektligjit**, përkufizohet operatori ekonomik, si ofrues shërbimi për bërjen të lexueshme të të dhënave të hedhura në sistem. Sugjerojmë, që kjo pikë të rishikohet dhe saktësohet në raport me **pikën 9, të nenit 4, të projektligjit**, ku parashikohet e drejta e operatorit ekonomik për transmetimin e të dhënave PNR. Kjo, me qëllim që të specifikohet qartë roli dhe proceset përpunuese që do të kryejë operatori ekonomik, në cilësinë e përpunuesit, në raport me të dhënat e grumbulluara nga SIP, si një mënyrë për garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave.

Në lidhje me **pikën 3, të nenit 3, të projektligjit**, sugjerojmë të shtohet germa “*f*” *depersonalizimin e të dhënave*”, si një nga veprimet kyçe të kryera në proceset përpunuese të të dhënave nga SIP.

Në lidhje me **pikën 6, të nenit 3, të projektligjit** parashikohet se baza e të dhënave të pasagjerit dhe bazat e tjera të të dhënave, do të përcaktohen në Rregulloren për Përpunimin e të Dhënave të Pasagjerit.

Sa më sipër, sugjerojmë riformulimin e **pikës 6, të nenit 3, të projektligjit** duke marrë në konsideratë faktin që aksesit në bazat e të dhënave të njihet vetëm me ligj dhe është ligji që mund të delegojë në instrumenta të tjerë, si aktet nënligjore apo marrëveshjet e përbashkëta, përcaktimin e elementëve të përpunimit sikurse janë mënyra, forma dhe niveli i aksesit.

Megjithatë duhet pasur parasysh se pavarësisht autorizimit me ligj të aksesit, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht dhe gjithnjë një akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në të dhënat e kërkuara. Për këtë arsye, duhet të sigurohet përputhshmëria me parimin e ligjshmërisë së përpunimit, të përcaktuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe, rrjedhimisht, të parandalohen cenime eventuale të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave. Si rezultat i përpunimeve të mundshme eksese (në tejkalim të qëllimit), është e domosdoshme që të merren masa konkrete (i) për sigurimin e gjurmueshmërisë së aksesit në të dhëna, si dhe (ii) përcaktimin e niveleve të aksesit në përputhje me dispozitat ligjore që e autorizojnë atë, në harmoni të plotë me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së institucionit që i është akorduar ky akses.

Në **pikën 4, të nenit 5 të projektligjit**, sugjerojmë që të hiqet togfjalëshi “*së bashku me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”. Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së legjislacionit të të dhënave personale, e si i tillë nuk bën pjesë tek autoritetet kompetente operative, të cilat duhet të nënshkruajnë procedurat standarde të punës.

Në vijim, në **nenin 9 të projektligjit** “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave”, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “*Për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale të zbatohen dispozitat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Zyra e Komisionerit sugjeron që titulli i **nenit 10 të projektligjit**, të riformulohet me këtë përmbajtje: “Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu, lidhur me **fjalinë e parë, të nenit 10 të projektligjit, ku specifikohet se:** “*Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës në Republikën e Shqipërisë është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtarinë e grumbullimit, përpunimit, transmetimit, transferimit, pseudonimizimit, anonimizimit dhe fshirjes së të dhënave të pasagjerit nga SIP-i...*”, Zyra e Komisionerit propozon që, pas anonimizimit, të shtohet termi “*depersonalizim*”, si një nga mënyrat/veprimet e përpunimit mbi të dhënat e pasagjerëve.

Më tej, sugjerojmë që, në këtë nen, të shtohet një pikë me përmbajtje të njëjtë me atë të germës “ç”, të nenit 19/7 të ligjit në fuqi nr. 71/2016 “*Për kontrollin kufitar*”, i ndryshuar.

Në vijim, duke qenë se projektligji synon përafrimin me legjislacionin evropian, ku ndër të tjera, edhe me Direktivën 2016/681 të BE, Zyra e Komisionerit sugjeron që, në **nenin 12 të projektligjit**, fjala “*pseudonimizim*” të zëvendësohet me fjalën “*depersonalizim*”, në përputhje me nenin 12 të Direktivës.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian për mbrojtjen e të dhënave personale (Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 dhe Direktivën 2016/681 të Bashkimit Evropian) propozojmë që të shtohet një dispozitë në këtë projektligj, lidhur me **personin e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave**, me përmbajtjen si vijon:

“Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale”

1. *Pranë SIP-it caktohet nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, përgjegjës për monitorimin e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.*

2. *Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale i komunikon Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës çdo rast të konstatimit të shkeljes së të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale.*
3. *Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale gëzon pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas këtij ligji.”.*

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi